

VENDIM
Nr. 185, datë 26.2.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 820, DATË 13.10.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËRORE TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13, të ligjit nr. 8748, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 820, datë 13.10.2010, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shitesa:

a) Paragrafi i dytë, i pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Lista me nr. 57 (pesëdhjetë e shtatë) përfundon me numrin rendor 240 (dyqind e dyzet).”.

b) Listës bashkëlidhur vendimit i shtohet fleta me numër 57 (pesëdhjetë e shtatë).

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe